

Mundësi për Bashkitë për aplikim në Thirrjen e 7-të të Interreg Euro-MED për Projekte të Transferimit në fushën e Turizmit të Qëndrueshëm

1. Synimi i thirrjes

Interreg Euro-MED ka hapur Thirrjen e 7-të për projekte në fushën e Turizmit të Qëndrueshëm, në kuadër të Mekanizmi Shumë-Programor Mesdhetar (Mediterranean Multi-Programme Mechanism - MMM). Thirrja synon të mbështesë transferimin, përshtatjen dhe zgjerimin e zgjidhjeve, instrumenteve, strategjive dhe planeve të veprimit të zhvilluara më parë në kuadër të programeve Interreg të përfshira në MMM.

Thirrja fokusohet ekskluzivisht në misionin “Enhancing Sustainable Tourism” – Promovimi i Turizmit të Qëndrueshëm. Qëllimi është që rezultatet e projekteve ekzistuese Interreg të mos mbeten vetëm në territorin ku janë zhvilluar, por të transferohen, përshtaten, ripërdoren dhe zgjerohen në terriore të tjera të Mesdheut. Një kërkesë themelore e thirrjes është që çdo projekt të bazohet në të paktën një rezultat konkret të zhvilluar në kuadër të një Programi MMM tjetër nga programi ku dorëzohet aplikimi. Pra, projekti nuk duhet të fokusohet kryesisht në zhvillimin e një produkti krejtësisht të ri, por në transferimin dhe kapitalizimin e një rezultati ekzistues. Rezultati i përzgjedhur duhet të identifikohet në MMM Joint Database dhe projekti duhet të shpjegojë qartë se si ky rezultat do të transferohet, përshtatet dhe/ose zgjerohet në kontekstin e ri territorial.

2. Kush mund të aplikojë

Subjektet kryesore të synuara të Programit janë institucionet publike kombëtare, rajonale dhe vendore të angazhuara në hartimin e politikave, të cilat bashkëpunojnë me organe të tjera përkatëse përgjegjëse për përcaktimin dhe zbatimin e politikave.

Subjektet e pranura për të aplikuar janë:

- Institucione vendore, rajonale dhe kombëtare me kompetenca që lidhen me turizmin, menaxhimin e burimeve dhe mbetjeve, planifikimin urban, transportin dhe çështjet mjedisore
- Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe operatorët ekonomikë në sektorin e turizmit
- Organizatat mbështetëse të biznesit
- Universitetet, institucionet e arsimit të lartë dhe qendrat kërkimore
- Shoqëria civile, komunitetet dhe shoqatat lokale, OJQ-të e përfshira në çështjet që lidhen me turizmin, konsumin, reduktimin e mbetjeve, ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe ruajtjen dhe restaurimin e ekosistemit
- Organizatat e Menaxhimit të Destinacionit
- Agjencitë e menaxhimit të turizmit
- Organizatat/organet e menaxhimit të energjisë
- Organizatat e riciklimit
- Operatorët e infrastrukturës (Autoritetet Portuale, Zonat e Mbrojtura Detare, etj.)

Për këtë thirrje, partneriteti duhet të përbëhet minimalisht nga **5 partnerë që përfaqësojnë 5 vende të ndryshme** brenda zonës së bashkëpunimit të Interreg Euro-MED. Partneri kryesor duhet të jetë një **organ publik ose një subjekt i së drejtës publike**.

Programi rekomandon përfshirjen e partnerëve institucionalë dhe rrjeteve relevante dhe rekomandon që numri i partnerëve të projektit të mos kalojë **8 partnerë**.

Për bashkitë është veçanërisht e rëndësishme që të kenë kompetencë të drejtpërdrejtë për marrjen dhe zbatimin e rezultatit që do të transferohet në territorin e tyre.

3. Cilat janë fushat dhe aktivitetet e mbështetura

Thirrja lidhet me katër objektiva specifike të Programit Interreg Euro-MED:

SO 1.1 – Zhvillimi dhe përmirësimi i kapaciteteve kërkimore dhe inovative dhe përdorimi i teknologjive të avancuara;

SO 2.4 – Promovimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe parandalimit të rrezikut nga fatkeqësitë, duke marrë në konsideratë qasjet e bazuara në ekosisteme;

SO 2.6 – Promovimi i tranzicionit drejt një ekonomie qarkulluese dhe me përdorim efikas të burimeve;

SO 2.7 – Përmirësimi i mbrojtjes dhe ruajtjes së natyrës, biodiversitetit dhe infrastrukturës së gjelbër, përfshirë zonat urbane, si dhe reduktimi i të gjitha formave të ndotjes.

Fushat e thirrjes janë:

Në veçanti, në kuadër të misionit "Turizmi i Qëndrueshëm", shumica e territoreve të programit preken nga çështjet që trajtohen prej tij. Megjithatë, zonat e mëposhtme janë veçanërisht të përshtatshme për projekte:

- Zonat e mbrojtura natyrore dhe zonat e gjelbërta në përgjithësi, që ofrojnë shërbime të ekosistemit
- Zonat urbane që vuajnë nga mungesa e burimeve ose nga teprica e mbetjeve për shkak të presionit të lartë turistik
- Ishujt dhe zonat e largëta
- Zonat rurale dhe malore
- Zonat bregdetare/detare
- Zonat me potencial për të ofruar alternativa të turizmit të qëndrueshëm ndaj aktiviteteve tradicionale turistike
- Zonat turistike veçanërisht të cënueshme ndaj ndryshimeve klimatike dhe fatkeqësive natyrore
- Zona të tjera me ujëra të brendshme të prekura nga presioni turistik (zona ligatinore në brendësi të territorit, ujëra të ëmbla, lumenj, liqene, diga, etj.)
- Zonat me interes të veçantë (trashëgimia natyrore dhe kulturore)

Në praktikë, temat e thirrjes për turizmin e qëndrueshëm përfshijnë:

Qeverisjen e përbashkët dhe strategjike të ofertës turistike, përmes strukturave të përhershme të qeverisjes, platformave digjitale, instrumenteve të politikave, zhvillimit të kapaciteteve dhe mekanizmave për vendimmarrje të bazuar në të dhëna.

Turizmin dhe tranzicionin e gjelbër, duke lidhur turizmin me mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e burimeve, zhvillimin territorial, shkëmbimin e praktikave dhe përfshirjen e komuniteteve dhe të rinjve.

Dimensionin social të turizmit, punësimin dhe aftësitë, duke përfshirë turizmin gjithëpërfshirës dhe të aksesueshëm, trajnimin, rikualifikimin dhe zhvillimin e mundësive të punësimit.

Produktet turistike inovative dhe të zgjuara, përfshirë transformimin digjital, inteligjencën artificiale, realitetin virtual, platformat digjitale, Living Labs, hackathons, zhvillimin e produkteve të reja turistike dhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve publike, sektorit privat, akademisë dhe aktorëve të tjerë.

Për bashkitë mund të jenë veçanërisht të përshtatshme projekte që synojnë transferimin e një zgjidhjeje ekzistuese për menaxhimin e destinacioneve turistike, digjitalizimin e shërbimeve turistike, turizmin e gjelbër, menaxhimin e mbetjeve në destinacione turistike, përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, zhvillimin e produkteve turistike të qëndrueshme ose përfshirjen e komuniteteve lokale.

4. Çfarë duhet të bëjë konkretisht projekti

Projektet e kësaj thirrjeje duhet të fokusohen në një **proces transferimi**.

Ky transferim mund të jetë transferimi i një zgjidhjeje të zhvilluar dhe testuar nga një subjekt te një subjekt tjetër, me qëllim përmirësimin e praktikave të punës ose të proceseve teknike, operacionale apo administrative. Mund të jetë gjithashtu transferimi i një strategjie ose plani veprimi të zhvilluar dhe testuar drejt një institucioni publik kompetent, me qëllim përmirësimin ose ndryshimin e politikave publike. Rezultati përfundimtar duhet të ketë karakter **transnacional dhe jo vetëm lokal**. Aktivitetet e mundshme përfshijnë masterclass-e tematike dhe peer reviews, aktivitete demonstrimi dhe testimi të zgjidhjeve, vizita studimore, përditësimin dhe përshtatjen e platformave ekzistuese, përshtatjen e rezultateve në kontekste të reja territoriale ose institucionale, hartëzimin e aktorëve, aktivitete trajnimi dhe ndërgjegjësimi, si dhe mbështetjen e institucioneve për integrimin e rezultateve në politikat dhe planet ekzistuese.

Rezultatet mund të përfshijnë masa për zbatimin e politikave, rekomandime, propozime rregullatore, Memorandume Mirëkuptimi ose marrëveshje bashkëpunimi, plane dhe raporte transferimi, mjete vlerësimi, udhëzues, toolkit-e, metodologji të përshtatura dhe dokumente të miratimit ose adoptimit institucional.

6. Cili është buxheti i thirrjes dhe buxheti për projekt

Buxheti indikativ i përgjithshëm i kësaj thirrjeje është rreth **8 milionë euro**, nga të cilat **6.4 milionë euro financim Interreg** dhe **1.6 milionë euro bashkëfinancim kombëtar**.

Në kuadër të thirrjes parashikohet financimi i rreth **10 projekteve**.

Buxheti maksimal për një projekt është **800,000 euro**.

Kohëzgjatja maksimale e projektit është **21 muaj**.

7. Si bëhet aplikimi

Aplikimi bëhet në mënyrë elektronike në platformën **Jems** të Programit Interreg Euro-MED: <https://jems.interreg-euro-med.eu/>

Formulari i aplikimit duhet të krijohet dhe të plotësohet në Jems nga **Lead Partner-i**, në emër të të gjithë partneritetit. Për secilin partner, përfshirë Lead Partner-in, duhet të ngarkohet deklarata përkatëse e partnerit e gjeneruar nga sistemi Jems, e datuar dhe e nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor. Për Associated Partners, kur aplikohen, duhet të dorëzohet deklarata përkatëse e gjeneruar nga Jems. Dokumentet duhet të ngarkohen në format PDF dhe dokumentet që kërkojnë nënshkrim duhet të jenë të datuara dhe të nënshkruara.

Vlerësimi fillon me kontrollin administrativ dhe të pranueshmërisë. Propozimet që nuk përmbushin kriteret minimale të pranueshmërisë nuk kalojnë në fazën e mëtejshme të vlerësimit. Më pas zhvillohet vlerësimi cilësor i projektit. Për këtë thirrje, vlerësohen veçanërisht relevanca me kontekstin e Euro-MED, karakteri i bashkëpunimit, logjika e ndërhyrjes, relevanca e partneritetit, parimet horizontale, plani i punës dhe buxheti.

8. Çfarë duhet të bëjë një bashki shqiptare që dëshiron të aplikojë

Për një bashki shqiptare, hapi i parë është identifikimi i një **rezultati konkret ekzistues në MMM Joint Database** që lidhet me një nevojë ose problem konkret të territorit të bashkisë.

Më pas duhet të identifikohet institucioni ose partneri që ka zhvilluar rezultatin dhe partnerët ndërkombëtarë që mund të përbëjnë një konsorcium prej të paktën pesë vendesh.

Bashkia duhet të përcaktojë qartë se çfarë rezultati do të transferojë në territorin e saj, pse ky rezultat është i përshtatshëm për kontekstin lokal, si do të përshtatet, cilat aktivitete do të zhvillohen gjatë transferimit dhe si rezultati do të integrohet në praktikën, politikat ose instrumentet e bashkisë.

9. Kur është afati i fundit

Afati përfundimtar për dorëzimin e projekt-propozimeve është **30 shtator 2026, ora 13:00 sipas orës së Brukselit**.

Pas dorëzimit të projektpropozimit, aneksët e detyrueshëm duhet të dorëzohen deri më 14 tetor 2026.

10. Linku i thirrjes

<https://interreg-euro-med.eu/en/call-7-mediterranean-multiprogramme-mechanism-coordinated-call/>